



**BASHKIA TIRANË**

Nr. prot 7976/2

Tiranë, më 8.6.2015

**AKT-MARRËVESHJE**

Lidhur sot, më datë \_\_\_\_\_ 2015, në Tiranë, ndërmjet palëve:

**BASHKISË SË TIRANËS**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë **Z. Lulzim Basha**, me adresë: shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, këtej e tutje e quajtur “**Bashkia**”

dhe

**Subjekti “Qendra UET”**, me adresë: Blv.Gjergj Fishta, Nd. 70, H. 1, Office 211A, Tiranë, përfaqësuar nga Znj.Blerjana Bino, (me dokument identifikimi kartë identiteti. 024829007,regjistruar si person juridik me Vendim nr.564, datë 16.11.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; me nr NIPT-i L01927452U

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

**Neni 1**  
**Objekti**

Objekti i kësaj aktmarrëveshje është bashkëpunimi i palëve për realizimin e projektit kulturor “Natyre Mort me Kulturë, Promovim Libri”.

**Neni 2**  
**Qëllimi**

Projekti artistiko – kulturor “Natyre Mort me Kulturë, Promovim Libri” synon të promovojë një këndvështrim të ri për kritikën letrare për ta bërë pjesë integrale të krijimtarisë shqiptare. Synimi i promovimit të këtij libri është pasurimi i literaturës shkencore shqipe, me një vëllim i cili ekspozon një pamoranë letrare të prozës shqipe, të paeksploruar më parë. Këtë arritje ta prezantojnë e promovojnë, përmes valencës së lartë intelektuale dhe kontributit shkencor. “Qendra UET” përmes këtij projekti hap një horizont të ri në fushën e kritikës letrare dhe studimeve në përgjithësi.

**Neni 3**  
**Baza ligjore**

Kjo aktmarrëveshje bazohet në: vendimin e Këshillit Artistiko-Kulturor nr.16, datë 27.05.2015, për realizimin e projektit kulturor, "Natyre Mort me Kulturë, Promovim Libri", projekt i paraqitur nga "Qendra UET" në të cilin konkludohet miratimi i këtij projekti dhe financimi i tij, në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 10 pika 3/II shkronja "a", nenit 44 shkronja "a" dhe nenit 72, pika 4/II shkronja "a", të ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000 për "Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 21.12.1992 për "Krijimin e këshillave artistiko – kulturore dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre" (i ndryshuar); vendimin e Këshillit Bashkiak nr.28, datë 23.12.2014 për "Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2015-2017 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015"; vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 35, datë 15.03.2001 "Rregullore mbi financimin e projekteve kulturore, artistike dhe sportive"; vendimit të Këshillit Bashkiak nr.10, datë 30.04.2014 mbi "Krijimin e Këshillit Artistiko-Kulturor.

#### **Neni 4**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e palëve**

##### 4.1 Qendra merr përsipër :

- të përmbushë detyrimet që lindin lidhur me aktivitetin artistiko – kulturor "Natyre Mort me Kulturë, Promovim Libri",
- të garantojë realizimin në performancë të lartë të veprimtarisë kulturore;
- me përfundimin e veprimtarisë të paraqesë në Drejtorinë e Artit dhe Kulturës, pranë Bashkisë së Tiranës, raportin përfundimtar të zhvillimit të veprimtarisë; 10 fotografi të datuara të çasteve të ndryshme të zhvillimit të veprimtarisë, si dhe ndonjë material tjetër publicitar, jo më vonë se 10 ditë nga zhvillimi i veprimtarisë;
- të paraqesë gjithë dokumentacionin e kërkuar në bazë të "Rregullores mbi financimin e projekteve kulturore, artistike dhe sportive të Bashkisë së Tiranës " (miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr.35, dt. 15.03.2001);
- të paraqesë të gjithë raportin financiar të nevojshëm, ku nxirren në pah shpenzimet e plota të kryera për realizimin e veprimtarisë;
- mban përgjegjësi të plotë para ligjit për dokumentacionin e plotësuar prej tij dhe faturat financiare justifikuese të paraqitura pranë Bashkisë.

##### 4.2 Bashkia e Tiranës merr përsipër :

- të mbështesë financiarisht realizimin e veprimtarisë, në vlerën prej 630.000 (gjashtë qind e tridhjet mijë) lekë, sipas Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 7976 dhe preventivit bashkëlidhur;
- të drejtën e prezantimit si organ bashkorganizator i veprimtarisë kulturore, me të gjitha mjetet e informimit masiv dhe publicitetit, ku realizohet publikimi i veprimtarisë kulturore;
- të drejtën e shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, në përputhje me legjisllacionin në fuqi, vendimin përkatës të Këshillit Artistiko-Kulturor dhe kushte të tjera të kontraktuara;
- kryerjen e pagesës në numrin e llogarisë bankare IBAN AL92 2121 1346 0000 0000 0023 4466, Banka Credins, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur.



15



**Neni 5**  
**Zbatimi i aktmarrëveshjes**

Palët përgjigjen për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë aktmarrëveshje. Në rast të mosrespektimit të tyre nga "Qendra UET", Bashkia ruan të drejtën e zgjidhjes së njëanshme të kësaj aktmarrëveshjeje dhe moskryerjen e financimit të veprimtarisë.

**Neni 6**  
**Kohëzgjatja**

Kjo aktmarrëveshje përfundon me përmbushjen e detyrimeve të ndërsjellta nga të dyja palët.

**Neni 7**  
**Dispozita të fundit**

Aneks i kësaj aktmarrëveshjeje dhe pjesë e pandarë e saj janë:

1. Projekti i realizimit të veprimtarisë, i konfirmuar nga Drejtoria e Artit dhe Kulturës (së bashku me preventivin).
2. Vendimi i Këshillit Artistiko-Kulturor nr 16, datë 27.05.2015

**Neni 8**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo aktmarrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët. Hartohet në katër kopje të barazvlefshme, nga dy kopje për secilën palë.

**PËR BASHKINË E TIRANËS**

**Z. Lulzim Basha**  
Kryetar

Përfaqësuar me autorizimin nr 7976/1, datë 05.06.2015  
nga

**Z. Arben Skënderi**  
Drejtore  
Drejtoria e Artit dhe Kulturës



**Znj. Blerjana Bilo**

Blerjana Bilo  
